



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 165

**Tiranë – E hënë, 18 shtator 2017**

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 15.9.2017	Për lirim nga detyra..... 7531
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 134, datë 6.9.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Operatori i sistemit të transmetimit OST sh.a.”, në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike..... 7531
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 6.9.2017	Mbi miratimin e rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike..... 7532
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 136, datë 6.9.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike” ..... 7538
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 137, datë 6.9.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike..... 7539
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 6.9.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thanzë” me fuqi të instaluar 2 mw..... 7539
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 6.9.2017	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e luajtshme, si dhe hipotekën mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë..... 7540
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 140, datë 6.9.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike..... 7541
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 141, datë 6.9.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 7542

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 142, datë 6.9.2017	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.....	7543
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 143, datë 6.9.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7543
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 144, datë 6.9.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	7544
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 4083/6, datë 11.9.2017	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës Shën Prodhomit”, si dhe “Projekti japonez dhe kopshtet e komunitetit”, në Bashkinë e Korçës.....	7544
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të zhdukur të shtetases Arsino Mersini.....	7545
	Vendim ( <i>i shkurtuar</i> ) për shpalljen të zhdukur të shtetases Evanthi Klemo.....	7545



**VENDIM**  
**Nr. 513, datë 15.9.2017**

**PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Z. Ilir Marko, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 134, datë 6.9.2017**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**“OPERATORI I SISTEMIT TË**  
**TRANSMETIMIT OST SHA”, NË**  
**AKTIVITETIN E OPERIMIT TË**  
**SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË**  
**ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16; 37, pika 2, germa “b”; 38, 53 dhe 58, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Operatori i sistemit të transmetimit OST sh.a.”, në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. , datë 3864 prot., datë 12.7.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike.

- Neni 58 i ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” parashikon që: “Para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.”

- Me vendimin nr. 43, datë 15.3.2017, Bordi i ERE-s ka vendosur miratimin përfundimtar të certifikimit të “Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC.

Aplikimi i shoqërisë OST sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikim), plotësuar;  
- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit), plotësuar;

- germa “c” (të dhëna për aplikuesin,) plotësuar;

Neni 9, pika 2:

- germat “a”, “b” (akti i themelimit/statuti), plotësuar;

- germa “c” (vërtetimi i regjistrimit nga QKB-ja) plotësuar;

- germa “d” (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar;

- germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë), plotësuar;

- germa “f” “Marrëveshje Koncesioni ose autorizimi nga KM-ja, në rastet e aplikueshme në përputhje me kuadrin ligjor përkatës”, kjo pikë e rregullores nuk gjen zbatim për këtë aktivitet;

- germa “g”, dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shitblerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete për kryerjen e aktivitetit të licencuar), plotësuar (subjekti ka depozituar në ERE certifikatat përkatëse të pronësisë).

Neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave), plotësuar;



- germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit), plotësuar;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), plotësuar;

- germa “d” (vërtetimin e pagesës së regjistrimit për aplikim në llogari të ERE-s), plotësuar.

Neni 9, pika 4.5 “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike”:

- germa “a” “Të dhëna për linjat e transmetimit”, plotësuar;

- germa “b” “Të dhëna për n/st e sistemit të transmetimit”, plotësuar;

- germa “c”. “Të dhëna për konsumatorët dhe përdoruesit e lidhur në sistemin e transmetimit”, plotësuar;

- germa “d” “Të dhëna për energjinë që parashikohet të transmetohet”, plotësuar;

- germa “e” “Diagrami i sistemit të transmetimit që tregon elementet ekzistuese dhe ato të perspektivës në format A1”, plotësuar;

- germa “f” “Planet e investimeve për përmirësimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit”, plotësuar;

- germa “g” “Lista e të punësuarve, profesioni, formimi”, plotësuar;

- germa “h” “Lista e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës”, plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit OST sh.a.”, në aktivitetin e operimit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë OST sh.a për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

#### VENDIM

Nr. 135, datë 6.9.2017

### **MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË PARAQITJES DHE MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE NGA OPERATORËT E TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “e”; 60, pika 9 dhe 75, pika 8, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s”, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për miratimin e “Rregulloreve të procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- ERE ka autoritetin të miratojë këtë rregullore, në bazë të neneve 60, pika 9 dhe 75, pika 8 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 63, datë 27.5.2016, filloi procedurat për miratimin e rregulloreve “Për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planeve të investimeve të operatorëve të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike”, si dhe të të licencuarve në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike që janë të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016.

- Me shkresën nr. 452, datë 7.6.2016, ERE njoftoi dhe kërkoi nga palët KESH sh.a, OST sh.a., OSHEE sh.a., si dhe Autoriteti i Konkurrencës, të shprehin opinionet dhe komentet me shkrim mbi këtë draft. Komente dhe sugjerime mbi draftin iu kërkuan edhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

- Në komunikimin e datës 10 janar 2017, ENC-ja ka bërë me dije qëndrimin e tij, ku ndër të tjera, ka konsideruar të panevojshme përfshirjen e të licencuarit në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike që janë të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik në këtë rregullore dhe propozon përjashtimin e saj nga parashikimet e kësaj rregulloreje.



- Në vlerësim të kuadrit ligjor në fuqi, angazhimit të vendit në kuadër të detyrimeve që burojnë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë Elektrike, miratuar me ligjin nr. 9501, datë 3.4.2006 dhe përcaktimeve të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, janë marrë në konsideratë kryesisht komentet e ENC-së në këtë draftrregullore.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

2. Subjektet që sipas kësaj rregulloreje, për të cilat ka filluar procedura e miratimit të planit të investimeve, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të mbyllin procedurën e miratimit me rregulloren “Për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
**Petrit Ahmeti**

### RREGULLORE

PËR PROCEDURAT E PARAQITJES DHE TË  
MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE  
NGA OPERATORËT E TRANSMETIMIT  
DHE TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE

#### KAPITULLI I

#### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

##### Neni 1

##### **Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 20, germa “e”; 60, pika 9 dhe 75, pika 8 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

##### Neni 2

##### **Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje janë procedurat e paraqitjes dhe të miratimit nga ERE, të planit të investimeve të OST-së dhe OSSH-së.

##### Neni 3

##### **Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë përmbajtjen dhe afatin e dorëzimit në kohë në ERE, të planit të investimeve të OST-së dhe OSSH-së, si dhe vlerësimin dhe analizën e kriterëve të aplikueshme dhe miratimin e tyre (ose rishikimin) nga ERE, për të siguruar që planet e investimit të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me kosto më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit, si dhe kërkesat e ENTSO-E lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit.

##### Neni 4

##### **Zbatimi**

Kjo rregullore aplikohet për operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilët kanë marrë nga ERE licencë për aktivitetet respektive.

##### Neni 5

##### **Përkufizime**

Termet e përdorur në këtë Rregullore do të kenë kuptimet e mëposhtme:

1. “Ligj” do të thotë ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

2. “Bordi” do të thotë organi vendimmarrës i ERE-s, i emëruar sipas ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

3. “ERE ose Enti Rregullator i Energjisë” do të thotë autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. “Aset” do të thotë aktivi afatgjatë material që përdoret nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe që i shërben realizimit të aktivitetit respektiv të licencuar.

5. “Biznes” do të thotë veprimtari e licencuar nga ERE për shërbimet e transmetimit ose të shpërndarjes së energjisë elektrike.



6. “OSSH ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

7. “Investim” nënkupton shpenzimet strategjike kapitale të një të licencuari (OST ose OSSH) për të përmirësuar ose për të shtuar asetet, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së licencuar.

8. “Plani i investimeve” nënkupton shpenzimet kapitale të planifikuara për një periudhë rregulluese të një të licencuari (OST ose OSSH, sipas rastit), që merr parasysh parimet, plotëson kriteret dhe përmban elementet e parashikuara në ligj dhe në këtë Rregullore. Planet e OST-së duhet të jenë në përputhje me TYNDP-në, e cila është zhvilluar për një periudhë 10-vjeçare dhe i është dorëzuar ENTSO-E.

9. “TYNDP” do të thotë plani 10-vjeçar i zhvillimit të rrjetit panevropian.

10. “ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity)” është Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

11. “ENC” do të thotë Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

12. “Person” do të thotë çdo person fizik ose juridik.

13. “Licencë” do të thotë një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

14. “I licencuar” do të thotë një person, i pajisur me licencë për aktivitetet e transmetimit apo të shpërndarjes së energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

15. “Baza e rregulluar e asetëve (RAB)” do të thotë vlera e asetëve fikse që zotërohen nga shoqëria dhe që përdoren për të kryer një nga veprimtaritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike.

16. “Periudha rregullatore” do të thotë periudha gjatë së cilës tarifat e reja bëhen efektive dhe rregullohen/rishikohen sipas vendimit të marrë nga ERE.

17. “Plani i rrjetit 10-vjeçar” i referohet planit 10-vjeçar të rrjetit që do të përgatitet nga OST sh.a.

18. “OST ose Operatorit i sistemit të Transmetimit” është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkuftare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

19. Çdo term që përdoret, por nuk është përcaktuar në këtë Rregullore dhe është e përcaktuar në ligj, do të ketë kuptimin e dhënë për atë term në ligj, me përjashtim të rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe.

20. “Ditë”, në çdo rast, në këtë rregullore do të kuptohet, ditë kalendarike.

## KAPITULLI II PLANET E INVESTIMEVE

### Neni 6

#### **Kërkesa të përgjithshme të hartimit të planeve të investimeve**

Në hartimin e planeve të investimeve operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike do të mbajnë parasysh parimet e mëposhtme:

a) Planet e investimeve do të jenë në përputhje me kërkesat e ligjeve, rregulloreve, metodologjive dhe të gjitha akteve nënligjore përkatëse, që rregullojnë studimet, projektimet dhe kryerjen e investimeve, përfshirë kërkesat për mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, mjedisit dhe të sigurisë kombëtare. Planet e investimit duhet të jenë në harmoni me strategjitë kombëtare të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike.

b) Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë që plani i investimeve i dorëzuar të jetë në përputhje me parashikimet e planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit në Shqipëri dhe me planin e ENTSO-E pan-EU TYNDP dhe në përputhje me informacionin e paraqitur në ENC për projektpropozimet me interes të ENC-së.

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit gjatë hartimit të planeve të investimeve duhet të marrin në



konsideratë informacionin mbi parashikimin e kërkesës si dhe informacionin mbi planet e investimeve për kapacitetet e reja gjeneruese.

d) Planet e investimeve duhet të hartohen në mënyrë që të sigurojnë efektivitet të lartë, kosto të ulët, përfshirë marrjen parasysh të masave për menaxhimin e kërkesës për energji elektrike.

e) Planet e investimeve duhet të marrin parasysh marrëdhëniet që operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike kanë me pjesëmarrësit e tjerë të tregut, për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergetik, si dhe plotësimin e kushteve të sigurisë dhe cilësisë së furnizimit me energji elektrike të klientëve.

f) Planet e investimeve do të jenë të hapura për publikun duke iu dhënë mundësinë të interesuarve përfshirë dhe institucionet e ndryshme shtetërore të japin komentet e tyre lidhur me këto plane.

#### Neni 7

### Përgjegjësitë e operatorëve

1. OST-ja dhe OSSH-ja duhet të përgatisin planet e investimeve sipas periudhave të rregullimit dhe për çdo vit pasardhës në përputhje me ligjin. ERE do të pranojë shtesa të planit të investimeve që janë paraqitur deri në gjashtë muaj pas paraqitjes së aplikimit të planit të investimeve, në mënyrë që të zvogëlojë barrën mbi OST-në dhe OSSH-në. Planet e investimeve do të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili do të përfshijë edhe paraqitjen tabelare dhe grafike të të dhënave referuese dhe një plan kohor zbatimi.

2. Operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike do të paraqesin në ERE raportin vjetor të zbatimit të planeve të investimeve të vitit paraardhës, duke treguar ecurinë e investimeve të planifikuara dhe duke siguruar shpjegim për çdo ndryshim në plan. Raporti vjetor do të dorëzohet jo më vonë se 3 muaj pas përfundimit të periudhës në të cilën zbatohet plani i investimeve.

#### Neni 8

### Planet e investimeve për operatorët e transmetimit të energjisë elektrike

1. Plani 10-vjeçar i investimeve për operatorin e transmetimit të energjisë elektrike sipas nenit 60 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” duhet të hartohet në një plan 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit, të rishikohet për çdo vit, duke

pasur parasysh planin 10-vjeçar dhe duhet të përmbajë investime që synojnë:

a) përmirësimin dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së tij dhe sigurisë së furnizimit të vendit me energji elektrike;

b) reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit;

c) krijimi/ritja dhe operimi i kapaciteteve të interkoneksionit me sistemet kufitare;

d) rritjen e mundësisë për shpërndarjen dhe kontrollin në distancë të flukseve të energjisë elektrike.

2. Në planifikimin e investimeve për të plotësuar synimet e mësipërme, operatori duhet të bazohet dhe të respektojë:

a) kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të transmetimit të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, si dhe procedurat e parashikuara për zhvillimin e sistemit të transmetimit;

b) informacionet dhe të dhënat e siguruar nga operatorët/pjesëmarrësit e tregut dhe përdoruesit e sistemit të transmetimit;

c) parashikimin e kërkesës dhe informacionin mbi treguesit e investimeve për kapacitetet e reja gjeneruese;

d) kriteret e projektimit të elementeve kryesore të rrjetit të transmetimit (linja dhe nënstacione);

e) periudhën e ndërtimit apo të rehabilitimit të një objekti;

f) analizën e plotë të kosto-përfitimit, sigurimin e efektivitetit të kostove të projektit dhe kostove të argumentuara, përfshirë plan investimesh të detajuar me afatet përkatëse (studim fizibiliteti, duke përfshirë vlerësimin e impaktit mjedisor).

3. Në planin e investimeve të parashikuar, operatori duhet të pasqyrojë listën e projekteve që do të zbatohet.

4. Plani i investimeve i paraqitur në ERE do të shoqërohet me relacione argumentuese lidhur me:

a) metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe ngarkesës pik sipas kushtit n-1, duke i paraqitur ato në mënyrë tabelare dhe grafike, që kanë diktuar ndërtimin apo rehabilitimin e nënstacioneve (TL/TM), kabinave të transformimit, pajisjeve rregulluese të tensionit etj.;

b) ndikimet e investimit në përmirësimin e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e performancës së sistemit, uljen e humbjeve teknike



dhe çështje të tjera që lidhen me performancën e operatorit të transmetimit etj.;

c) kostot, informacion i detajuar mbi humbjet, kërkesat për financim dhe burimet e tyre, periudhat e shlyerjes së investimeve dhe çështje të tjera;

d) analiza e plotë e përfitimit të kostos që vërteton efektivitetin e çdo projekti të planifikuar dhe justifikon kostot që lidhen me to;

e) implementim i detajuar i planit/skedulimit, i shoqëruar nga një studim fizibiliteti, studim për impaktin në mjedis, të drejtat pronësore dhe të shfrytëzimit.

Neni 9

### **Planet e investimeve për operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike**

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes për 5 vitet e ardhshme kalendarike, sipas nenit 75, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Ky plan duhet të përmbajë investime që synojnë:

a) rritjen e shkallës së sigurisë së sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike;

b) zvogëlimin e humbjeve teknike dhe joteknike në rrjetin e shpërndarjes;

c) mbajtjen e parametrave teknikë të furnizimit me energji elektrike të parashikuar në Kodin e Shpërndarjes;

d) plotësimin dhe modernizimin e sistemit të matjes së energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes.

2. Në hartimin e planeve të investimeve operatori duhet të bazohet dhe të respektojë:

a) kriteret e planifikimit dhe të zhvillimit të sistemit të shpërndarjes të përcaktuara në Kodin e Shpërndarjes;

b) studimi i ngarkesave ekzistuese dhe parashikimi i zhvillimit të ngarkesave në të ardhmen;

c) informacionet dhe të dhënat e siguruara nga OST-ja, pjesëmarrësit e tregut dhe klientët kryesorë të lidhur me sistemin e shpërndarjes;

d) informacioni i paraqitur nga vlerësimi i treguesve të zhvillimit të kapaciteteve të reja gjeneruese;

e) kriteret e projektimit të elementeve kryesore të rrjetit të shpërndarjes (nënstacione, kabina transformimi, linja shpërndarëse të TM dhe TU etj.);

f) periudhat kohore të zbatimit të investimit për ndërtimin apo rehabilitimin e një objekti.

3. Në planin e investimeve të parashikuara, operatori duhet të pasqyrojë listën e projekteve që do të zbatojë.

4. Plani i investimeve shoqërohet me relacione argumentuese, lidhur me:

a) metodologjitë e ndjekura për parashikimin e kërkesës, ngarkesës dhe ngarkesës pik sipas kushtit n-1, duke i paraqitur ato në mënyrë tabelare dhe grafike, që kanë diktuar ndërtimin apo rehabilitimin e nënstacioneve (TL/TM), kabinave të transformimit, pajisjeve rregulluese të tensionit etj.;

b) ndikimet e investimit në përmirësimin e kapaciteteve transmetuese, përmirësimin e performancës së sistemit, uljen e humbjeve teknike dhe çështje të tjera që lidhen me performancën e operatorit të transmetimit etj.;

c) kostot, informacion i detajuar mbi humbjet, kërkesat për financim dhe burimet e tyre, periudhat e shlyerjes së investimeve dhe çështje të tjera;

d) analiza e plotë e përfitimit të kostos që vërteton efektivitetin e çdo projekti të planifikuar dhe justifikon kostot që lidhen me to;

e) implementim i detajuar i planit/skedulimit, i shoqëruar nga një studim fizibiliteti, studim për impaktin në mjedis, të drejtat pronësore dhe të shfrytëzimit.

### **KAPITULLI III**

#### **PROCEDURAT E PARAQITJES DHE TË MIRATIMIT TË PLANIT TË INVESTIMEVE**

Neni 10

#### **Procedura e paraqitjes dhe e miratimit të planit të investimeve**

1. Një procedurë për miratimin e planit të investimeve fillon me paraqitjen e një kërkesë për miratim të planit të investimeve nga OST-ja apo OSHEE-ja së bashku me një plan të detajuar investimesh, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 8 dhe 9, si dhe shtojcën 1 të kësaj rregulloreje. I licencuari do të paraqesë planin e investimeve në ERE, pasi ta ketë konsultuar me palët e interesuara.

2. Nëse kërkesa për miratimin e planit të investimeve është bërë konform kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore, Bordi i ERE-s merr vendim për fillim procedure të shqyrtimit të planit të investimeve.





3. Para marrjes së miratimit të planit të investimeve nga ERE, OST-ja të marrë opinionin nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik Turizmit dhe Tregtisë në lidhje me planin e investimeve që do të paraqesë.

4. ERE, pasi shqyrton planin e investimeve dhe nëse e gjen atë në përputhje me kërkesat e lartpërmendura, e miraton tërësisht.

#### Neni 11

##### **Afatet e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve**

1. ERE ka përcaktuar afatet për paraqitjen dhe miratimin e planit të investimeve në kontekstin e aplikimit dhe miratimit të tarifave për veprimtaritë e ushtruara nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes në tregun e energjisë elektrike. Këta të fundit do të paraqesin në ERE planin e investimeve për vitin pasardhës në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifë.

2. ERE publikon njoftimin për paraqitjen e planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes jo më vonë se 7 (shtatë) ditë nga data e pranimit të aplikimit për marrjen e komenteve nga të interesuarit. Të interesuarit mund të paraqesin komentet e tyre brenda 15 ditëve nga publikimi.

3. ERE mund të kërkojë sqarime ose të bëjë pyetje lidhur me planin e investimeve të paraqitur nga aplikuesi, nga dita e paraqitjes së tij deri në miratim.

4. ERE mund të organizojë seanca dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve të interesuara.

5. ERE shqyrton dhe merr vendim për miratimin e plotë të planit të investimeve para miratimit të tarifave të transmetimit apo shpërndarjes.

#### Neni 12

##### **Kriteret për miratimin e planit të investimeve**

1. ERE mund të miratojë planin e investimeve në tërësi sipas përparësisë së projekteve. Informacioni i paraqitur në planin e investimeve përdoret nga ERE për të përcaktuar bazën e rregulluar të aseteve (RAB), të veprimtarive të licencuara për aktivitetet respektive në sektorin e energjisë elektrike.

2. Në miratimin e planit të investimeve, ERE merr në konsideratë:

a) nëse plani përmirëson nivelin dhe cilësinë e shërbimit;

b) nëse plani është në gjendje të përmirësojë dhe të reduktojë humbjet teknike dhe joteknike;

c) nëse plani përmban dhe reflekton masat për minimizimin e kostos, duke përfshirë praktikat transparente dhe të drejta të blerjeve;

d) nëse plani është mjaftueshmërisht i detajuar, i dokumentuar dhe konsiston në një shkallë të duhur fleksibiliteti në zbatim;

e) nëse plani i investimeve ka analizuar dhe vlerësuar disa alternativa dhe ka argumentuar faktin se pse alternativat e tjera nuk janë përfshirë;

f) nëse plani i investimeve është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike;

g) nëse plani është i realizueshëm brenda afatit të përcaktuar.

3. Nëse ERE e sheh të arsyeshme mund të kërkojë kryerjen e një oponente për vlerësimin e aspekteve teknike dhe eficiencën ekonomike të investimit.

#### Neni 13

##### **Njoftimi për vendimin**

1. Brenda 3 ditëve kalendarike nga zbardhja e vendimit përfundimtar, ERE do të njoftojë operatorin e transmetimit apo të shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe do t'i dërgojë atij një kopje të vendimit.

2. Vendimi i Bordit të ERE-s për miratimin e planit të investimeve për operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike publikohet në Fletoren Zyrtare.

3. Brenda 7 ditëve nga marrja e vendimit të Bordit të ERE-s, i licencuari ka të drejtë të paraqesë kërkesën për rishikim në ERE, konform Rregullores së funksionimit, organizimit dhe procedurave të ERE-s.

#### KAPITULLI IV

##### **DISPOZITA TË TJERA**

#### Neni 14

##### **Informacioni konfidencial**

Në rast se ndonjë operator pretendon se plani i investimeve të tij përmban një numër informacionesh dhe të dhënash, që ai i konsideron konfidenciale, ai do t'i shënojë si konfidenciale kur paraqet planet e investimeve dhe të tilla informacione dhe të dhëna do të vlerësohen nga



ERE, nëse janë të tilla, sipas rregullave dhe procedurave që aplikohen për këto lloj informacionesh dhe të dhënash.

Neni 15

### Ankimi gjyqësor

Kundër vendimit të Bordit të ERE-s, për miratimin ose jo të planit të investimeve, operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike, mund të bëjnë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.

## KAPITULLI V

Neni 16

### Amendimi i Rregullores

Kjo Rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE-s, në përputhje me rregullat e organizimit dhe të funksionimit dhe procedurave të ERE-s.

Neni 17

### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kjo rregullore botohet në Fletoren Zyrtare.

## SHTOJCË 1

### Tabela e investimeve për vitin \_\_\_\_\_

Përshkrimi i grupit të asetëve (në përputhje me listën e llogarive)	Numri i llogarisë	Koha e pritshme e vënies në punë	Vlera e pritshme e kapitalizuar (për t'u përfshirë në RAB)	Jetëgjatësia e pritshme	Amortizimi vjetor i pritshëm

## VENDIM

Nr. 136, datë 6.9.2017

### MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGIJË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 17, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Referuar nenit 17, pika 4, ERE përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve në përputhje me rregulloren përkatëse.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 137, datë 6.9.2017****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALIN TRADING” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 13, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë “Alin Trading” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 138, datë 6.9.2017****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AFRIMI K” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “THANZË” ME FUQI TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “b” nuk është



plotësuar. Germat “a”, “c”, “d”, “p” dhe “g”, plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3 dhe 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 9, pika 2, germa “b”, do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, neni 11, pika 1, t’i paraqesë ato në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Afrimi K” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë nga HEC “Thanzë” me fuqi të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM Nr. 139, datë 6.9.2017

### **MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “HYDRO POWER PLANT OF KORÇA” SHPK PËR VENDOSJE TË PENGUT MBI KUOTAT E KAPITALIT, SENDET E LUAJTSHME, SI DHE HIPOTEKËN MBI SENDET E PALUAJTSHME TË SHOQËRISË**

Në mbështetje të neneve 16; 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 6; 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119,

datë 21.7.2016, si dhe të pikave 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016 dhe nenit 19 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2016, pasi shqyrtoi relacionin mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e luajtshme, si dhe hipotekën mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7, pika 1, germa “a” “Një ekstrakt historik i shoqërisë tregtare të të licencuarit, të lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “b” “Veprimtaria e licencuar”, plotësuar (subjekti është i licencuar nga ERE në aktivitetet e prodhimit, tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike).

- Neni 7, pika 1, germa “c” “Gjendja financiare e kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “d” “Një përshkrim të kandidatit të propozuar për transferim asetit, që përfshin informacion të përgjithshëm mbi veprimtarinë e shoqërisë, që përfshihet në transaksion të tri viteve të fundit dhe të vitit të fundit, kur shoqëria ka më pak se 3 vjet që është krijuar, gjendjen financiare”, plotësuar. (Banka përfituese është Intesa San Paolo Albania dhe subjekti ka depozituar dokumentacion të detajuar mbi përshkrimin e veprimtarisë së saj.)

- Neni 7, pika 1, germa “e” “Arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “p” “Efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “g” “Efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifatat e aktivitetit të licencuar”, plotësuar.



- Neni 7, pika 1, germa “h” “Marrëveshje paraprake e nënshkruar midis palëve në një nga format e parashikuara nga ligji, për transferimin e aseteve. Marrëveshja duhet të përmbajë një listë të detajuar të aseteve që kërkohet të transferohen”, plotësuar.

- Neni 7, pika 1, germa “i” “Deklaratë me shkrim e personit tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shprehë gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit”, pa plotësuar

- Neni 7, pika 1, germa “j”. Nëse ka pasur, listën e transferimeve të kryera me herët nga i njëjti subjekt, subjekti “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. ka një transferim të mëhershëm asetesh për të cilin ERE është shprehur me vendimin nr. 171, datë 24.12.2012 “Për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. për lënie peng si kolateral të aseteve të saj pranë BERZH-it”.

- Neni 7, pika 3 “Subjektet koncensionare të licencuara, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të aseteve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të aseteve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marrëveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë te përfituesi”. Nuk rezulton që subjekti të ketë depozituar në ERE miratimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për këtë vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit, sendet e luajtshme, si dhe hipotekën mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.

Objekt i Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 119, datë 21.7.2016 janë shitja, dhënia me qira, transferimi, hipotekim, barre ose çfarëdoq disponimi tjetër të pajisjeve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhim, transmetim, shpërndarjes së energjisë elektrike.

Kuotat e kapitalit dhe sendet e paluajtshme që nuk i shërbejnë aktivitetit të licencuar nuk janë objekt shqyrtimi nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” sh.p.k. për vendosje të pengut mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë.

2. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Hydro Power Plant of Korça” për vendosje të pengut mbi kuotat e kapitalit dhe sendet e luajtshme.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 140, datë 6.9.2017

#### MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 prot., datë 11.5.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 prot., datë 12.5.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 85, datë 7.6.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike.



Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gjerat “a”, “b”, “c” “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

#### VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 141, datë 6.9.2017

### MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SHA, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “d”; 5, pika 1, germa “d”; 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e

Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Shoqëria “Albpetrol” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 prot., datë 11.5.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 prot., datë 12.5.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 86, datë 7.6.2017, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “Albpetrol” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gjerat “a”, “b” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “p”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

#### VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
Nr. 142, datë 6.9.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË  
LLOGARITJES SË TARIFËS SË  
PËRDORIMIT TË RRJETIT TË  
TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES  
SË GAZIT NATYROR.**

Në mbështetje të neneve 16; 32 dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për gazin natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe të Çmimeve mbi miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”,

konstatoi:

- ERE është organi kompetent që miraton metodologjinë dhe përcakton tarifën për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes, tarifën e lidhjes me rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, tarifën për aksesin në hapësirat e depozitimit dhe impiantet e GNL-së dhe tarifën e furnizimit për klientët fundorë që furnizohen në bazë të detyrimit të shërbimit publik.

- Kjo metodologji mbështetet në parashikimet e neneve 16, 32 dhe 33 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.

2. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
Nr. 143, datë 6.9.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “THE  
BLUE STAR” SHPK, NË AKTIVITETIN E  
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “The Blue Star” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM**  
**Nr. 144, datë 6.9.2017**

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË**  
**“ENERGY TO ENERGY” SHPK, NË**  
**AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË**  
**ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1 germa “e”; nenit 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.9.2017, pasi shqyrtoi relacionin për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të licencojë shoqërinë “Energy to Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**KËRKESË**

**Nr. 4083/6, datë 11.9.2017**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës Shën Prodhomit”, si dhe “Projekti japonez dhe kopshtet e komunitetit”, në Bashkinë e Korçës.

Subjekti kërkues është Bashkia e Korçës. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të





pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumenteve të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit për projektin “Rikonstruksion i rrugës “Shën

Prodhomit”” është 198 423 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e njëzet e tre) lekë, ndërsa për “Projektin japonez dhe kopshtet e komunitetit”, vlera totale e shpronësimit është 1 633 522 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet e dy) lekë.

ZËVENDESMINISTËR I PUNËVE TË  
BRENDSHME  
Rovena Voda

**1. Lista emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit  
“Rikonstruksioni i rrugës Voskopojë - Shën Prodhom”, Bashkia Korçë**

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Zona kadastrale	I regjistruar pranë ZVRPP-së me nr.	Statusi i pronës sipas ZVRPP-së	Sipërfaqja e cila shpronësohet (m <sup>2</sup> )	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera	Dokumenti i pronësisë
1	Bashkëpronarët Shkëmbi Cale	3819	1000/2	Arë	31	100	3,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
2	Vrenos Mestan Shahinas	3819	994/2	Arë	9	100	900	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
3	Donika Hasani, Përparim Hasani	3819	994/29	Arë	24	100	2,400	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
4	Begator Mahmut Mukallari	3819	1003/1	Arë	2	100	200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
5	Qemal Idriz Skënderi	3819	955/20	Arë	12	100	1,200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
6	Jonuz Mersin Bezhani	3819	960/13	Arë	400	100	40,000	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
7	Lefter Ilia Samara	3819	960/12	Arë	165	100	16,500	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
8	Nastas Toli Grosi	3819	823/3	Arë	11	100	1,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
9	Jani Thoma Bozda	3819	811/27	Arë	21	100	2,100	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
10	Manastiri i Shën Prodhomit	3819	800	Arë	53.4	100	5,340	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
11	Manastiri i Shën Prodhomit	3819	800/1	Arë	632	100	63,200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
12	Gjergji Vasillaq Tërpo	3819	758/1	Arë	15	100	1,500	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
13	Liljana Jorgji Tërpo	3819	759	Arë	407	100	40,700	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
14	Edgar Stavro Frashëri	3819	954/9	Arë	90	100	9,000	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
<b>Totale</b>							<b>187,240</b>	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
1	Astrit Sulejman Bebri	3819	823/1	Truall	53	211	<b>11,183</b>	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
<b>Totale</b>							<b>198,423</b>	

**2. Lista emërore e personave dhe pronave që do të shpronësohen për realizimin e projektit  
“Parku japonez dhe kopshtet e komunitetit”, Bashkia Korçë**

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	ZK	Nr. I pas.	Statusi i pronës sipas ZVRPP-së	Sip. e truallit që shpron., (m <sup>2</sup> )	Çmimi i truallit lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e truallit	Dokumenti i pronësisë
1	Naum Gogo, Gjergji Gogo	8562	3/616	Truall	180.4	9055	<b>1,633,522</b>	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
<b>Totale</b>							<b>1,633 522</b>	

**VENDIM**  
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr. 62-2017-3703-(1096), datë 27.7.2017, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Arsino Mersini, e bija e Osmenit dhe e Merushes, e datëlindjes 4.5.1979 në datën 1.5.1997, si dhe caktimin e nënës së saj Merushe Mersini, si kujdestare për administrimin e pasurisë së saj.

**VENDIM**  
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 635, datë 3.7.2017, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Evanthi Klemo, e bija e Vasilit dhe e Afërditës e datëlindjes 26.10.1936, lindur në Gjirokastrë e banuese në Berat, si dhe caktimin e motrës së saj Aleksandra Klemo, si kujdestare për administrimin e pasurisë së saj.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 140 lekë